



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of Minister of Justice

Nr. 110 /2026
Datë: 05 . 06 .2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 08/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 05/L-118, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministria dhe Ministria e Drejtësisë në Detyrë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Caktohet Komisioni *Ad-hoc* për pranimin dhe transferimin e rasteve dhe të dhënave tjera relevante që ndërlidhen me procedurën përmbartimore që gjenden në zyrën përmbartimore të përmbartuesit privat Zija Bala, në këtë përbërje:

- 1.1. Fadilete Hoxhaj Blakçori, Udhëheqëse e Divizionit për Profesione të Lira/MD, kryesuese;
- 1.2. Burbuqe Spahija Kërveshi, Zyrtare e Lartë Ligjore/MD, anëtar/e;
- 1.3. Durim Shala, Zyrtar për Punë Juridike dhe Administrative, Oda Përmbartuesve Privat /OPP, anëtarë.

2. Obligohet Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi që lëndët dhe të dhënat e tjera relevante që ndërlidhen me procedurën përmbartimore që është në zhvillim e sipër si dhe lëndët e përfunduara në zyrën e përmbartuesit privat z. Zija Bala, të pranuarat t'i transferoj në mënyrë proporcionale tek përmbartuesit privat të emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Pejë.

3. Obligohet Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi që gjatë pranimin dhe transferimit të lëndëve përmbartimore të evidentoj dhe bartë edhe detyrimet financiare, tarifat përmbartimore dhe shpenzimet procedurale që ndërlidhen me secilën lëndë përmbartimore, konform Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

4. Obligohet Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi që në kohën e pranimin dhe transferimit të lëndëve dhe të dhënave të tjera që ndërlidhen me procedurën përmbartimore të ftoj që të jenë prezent edhe përmbartuesit privat nga pika 2 e këtij vendimi.

5. Obligohet Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi, që me rastin e pranimit dhe transferimit të lëndëve dhe të dhënave tjera relevante që ndërlidhen me procedurën përmbartimore përkatëse të mbaj procesverbal.

6. Komisioni fillon punën nga dita pasuese e pranimit të këtij vendimi dhe nuk duhet të ketë ndërprerje dhe shkëputje deri në përfundimin e kësaj çështje.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Donika Gërvalla Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në Detyrë



Vendimi i dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit;*
- *Z. Zija Bala;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;*
- *Odës së Përmbartuesve Privat;*
- *Gjykatës Themelore në Pejë;*
- *Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*